

VENDIM
Nr. 13, datë 23.1.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “ALBPETROL” SHA, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 50, nenit 22, pika 2, germa “c”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe nenit 4, pika 1, germa “c”, nenit 5, nenit 8, nenit 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2 dhe nenin 10, pikat 1 dhe 4, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017, si dhe nenit 15, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 23.1.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 5/4, datë 13.1.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Albpetrol” sh.a., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror.

konstatoi se:

- Shoqëria “Albpetrol” sh.a., me shkresën protokolluar në ERE nr. 837 prot., datë 23.12.2019, ka aplikuar për pajisjen me licencë në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë).

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar, i krijuar si detyrim i ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe ligjit nr. 7667, datë 28.1.1993, “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”, regjistruar si person juridik shqiptar, me vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë, me nr. 21158 akti, datë 8.4.1999, më tej regjistruar në QKB dhe mban numrin e identifikimit (NUIS) J82916500U.

- Aplikimi i shoqërisë “Albpetrol” sh.a., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim neni 9, pika 1:

- germa a, plotësuar;
- germa b, plotësuar por jo në formën e kërkuar nga rregullorja;
- germa c, plotësuar por jo në formën e kërkuar nga rregullorja;
- germa d/i, plotësuar pjesërisht (mungon akti i themelimit);
- germa d/ii, plotësuar pjesërisht (mungon vërtetimi i gjendjes gjyqësore);
- germa d/vi, plotësuar pjesërisht (mungojnë vërtetimet e titujve të pronësisë);
- germa e/v, është depozituar vërtetim i kryerjes së pagesës së aplikimit.

Në lidhje me dokumentacionin e munguar apo që ka nevojë të plotësohet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi dhe që ka të bëjë me:

formën e aplikimit, neni 9, pika 1, germa “b” (informacion i përgjithshëm për aplikantin), germa “c” (të dhëna mbi aplikantin), germa “d” (dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor), germa “e” (dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale), neni 9, pika 2, dokumente specifike për llojin e licencës, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 97, datë 4.7.2017, t’i paraqesë këto dokumente në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë), për një afat 10-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti